

Data: / /2023

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “RINOVIMI I SISTEMIT TË MBROJTJES SË 2 AGREGATËVE ME FURNIZIM INSTALIMIN/KONFIGURIMIN TË DY PANELEVE TË REJA, I KOMPLETUAR ME MBROJTJET DIXHITALE PËR GJENERATORIN, TRANSFORMATORIN E FUQISË DHE TE RELEVE NJËVEPRIMËSHE PËR HEC FIERZË”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Rele për qëllime të përgjithshme -31221200-3**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 114,000,000 (Njëqind e katërbëdhjetë milion) Lekë pa TVSH ose 1,010,369 (Një milion e dhjetëmijë e tretëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) Euro pa TVSH.

**Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07/04/2023 është 112.83 Lekë/Euro.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

### **Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Në Nenin 82, të LPP “*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të fondit limit.

*Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke marrë ne konsiderate specifiken e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues te paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike te kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare te jete jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të fondit limit.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;

**ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, për periudhën Janar 2023 – Mars 2023 minimalisht 2 (tre) nxhinierë elektrik/elektronik.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diplomën e inxhinierëve;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Janar 2023 – Mars 2023.

**Argumentimi:** Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kërkesa teknike që OE të ketë në stafin e tij minimalisht 2 (dy) inxhinierë elektrik/ elektronik, është një kërkesë në përputhje me objektin e kontratës dhe specifikimet teknike, pasi proceset e zbatimit të tij, referuar kërkesave teknike të përcaktuara në specifikimet teknike janë specifike dhe kërkojnë një nivel të lartë inxhinierik. Kjo procedurë prokurimi, gjatë zbatimit të kontratës kërkon nivel të lartë profesional dhe kryerjen e proceseve inxhinierike të zbatimit të projektit nga inxhinierë elektrik ose elektronik me eksperiencë në menaxhimin e të tilla projekteve, për të garantuar cilësi dhe siguri të lartë në realizimin me sukses të shërbimeve në përputhje me specifikimet teknike.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, për periudhën Janar 2023 – Mars 2023 një minimum punonjësish të çertifikuar për:

- 1 (një) specialist i çertifikuar për sigurinë teknike në punë ndaj elektricitetit (dëshmi kualifikimi i sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të).
- 1 (një) punonjës i çertifikuar përdorimin e paisjeve testuese që do të përdoren për komisionimin e releve dhe testimin e CT-ve.
- 1 (një) punonjës i çertifikuar mbi testimin e mbrojtjes së transformatorëve të fuqisë

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:**

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Çertifikatat përkatëse
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Janar 2023 – Mars 2023 .

**Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Theksojmë se ky projekt është i një niveli të lartë teknologjik, pasi nuk është një zëvendësim i thjeshtë pjesë këmbimi, por është projekt tërësisht i ri, i cili do të bëjë rinovimin teknologjik të sistemit ekzistues, me një sistem të ri mbrojtjesh dixhitale/numerike të gjeneratës së fundit të provuar në industri, që përfshin projektimin, furnizimin, instalimet dhe integrimin në skemën elektrike egzistuese, programimet, testimet e provat e komisionimit, trajnimi i nivelit të avancuar të specialisteve të KESH, si dhe testimet e provat me ngarkesë të agregateve të prodhimit me sistemet e reja të mbrojtjeve.

**2.3.5** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributor të autorizuar për mallrat objekt prokurimi. *Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).*

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2.3.6** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike.

*Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT. Katalogu duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe për mallrat objekt prokurimi.*

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për projekte të ngjashme për rinovimet e sistemit të mbrojtjeve të gjeneratorëve dhe transformatorëve të lëshuara nga institucione të autorizuar me ligj ose nga prodhuesi të kryera më parë, që të vërtetojnë pajtueshmërinë e sistemit të mbrojtjeve të prodhuara, me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë se mallrat janë të rinj, të pa përdorur.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me anë të këtyre deklaratave AK krijon bindjen se operatori ekonomik do të përmbush kontratën bazuar në specifikimet dhe kërkesat teknike të kërkuara nga AK, duke garantuar furnizimin me mallra të reja.

**2.3.9** Operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë propozimin teknik si dhe skemën e lidhjes të konfirmuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku të paraqiten funksionet e mbrojtjes dhe dublimi i tyre.

*Secili nga dokumentat e paraqitur duhet të mbajë të dhëna të sakta si e-mail, tel në rast verifikimi nga ana e AK.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 36 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara.

Theksojmë se ky prokurim në detyrat e tij, ndër të tjera përveç lëvrimin të mallrave të reja, përmban hartimin e një projekti të një niveli të lartë teknologjik, nuk është një zëvendësim i thjeshtë pjesë këmbimi, por projekt tërësisht i ri, i cili do të bëjë rinovimin teknologjik të sistemit ekzistues, me një sistem të ri mbrojtjesh dixhitale/numerike të gjeneratës së fundit të provuar në industri, që përfshin projektimin, furnizimin, instalimet dhe integrimin në skemën elektrike egzistuese, programimet, testimet e provat e komisionimit, trajnimi i nivelit të avancuar të specialisteve të KESH, si dhe testimet e provat me ngarkesë të agregateve të prodhimit me sistemet e reja të mbrojtjeve.

**2.3.10** Operatori ekonomik për pikat 10 dhe 12 të listës sipas pikës 9 të specifikimeve teknike, duhet të dëshmojë me anë të deklaratave të lëshuar nga prodhuesit / distributorët e autorizuar se ka suportin e tyre gjatë gjithë realizimit të kontratës.

#### **Argumentimi:**

Sistemi i SCADA i centralit ka një rendësi kritike për sa i përket operimit të Hidrocentraleve. Punimet që do të kryhen në lidhje me integrimin e sinjaleve të reja në SCADAn e HEC Fierzë, realizohen duke bërë ndërhyrje në sistemin ekzistues për të konfiguruar sinjalet e reja. Operatori Ekonomik duhet të garantojë që këto punime do të

realizohen në përputhje me rregullat teknike të programimit në këtë sistem, me softet përkatëse të licensuara, pa cënuar sigurinë dhe operimin e sistemit SCADA në HEC.

Për parametrizimin e funksioneve shtesë në relete ekzistuese të AG1 dhe AG3, OE duhet të krijojë bindjen tek AK që ka kapacitetet teknike për të kryer proceset e punës me softin përkatës e të parametrizimit të releve. Ndërhyrja në parametrizimet e releve të mbrojtjes së gjeneratoreve dhe transformatoreve, duhet të realizohet me përgjegjësi dhe OE duhet të garantojë që për të kryer këto punime ka suportin e duhur teknik.

**2.3.11** OE për realizimin e kontratës me qëllimin e inspektimit, testimit dhe komisionimit të paisjeve dhe makinerive duhet të disponojë aparatet testuese si më poshtë:

1. Instrument multifunksional për matjet në transformator, saturimit të rezistencës së pështjellave, impedancës, tangjent deltës, koeficientit të fuqisë, etj.
2. Instrument multifunksional për testimin dhe komisionimin e releve mbrojtëse me injektim sekondar.
3. Oshiloskop

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorezojnë vertetim pronësie/kontrate qeraje (fature pronësie, cdoganimi etj) te mjeteve dhe pajisjeve që disponojnë.*

**Argumentim:** Për realizimin e testeve sipas specifikimeve teknike, OE duhet të garantojë që ka kapacitetet teknike për të përket paisjeve testuese, që të realizojë të gjitha testimet e transformatoreve të rrymës dhe testimet e releve dixhitale.

1- Instrument multifunksional për matjet në transformator, saturimit të rezistencës së pështjellave, impedancës, është i domosdoshëm për të nxjerrë karakteristikat e saturimit të transformatorëve të rrymës në mënyrë që të konkludohet në një analizë të mirëfilltë teknike.

2- Instrument multifunksional për testimin dhe komisionimin e releve mbrojtëse me injektim sekondar, është metoda me efikasë për simulimin e avarive ose defekteve për të testuar veprimin e secilit fuksion mbrojtje në disa skenare të ndryshëm.

3- Për të arritur në një analizë të plotë vizuale të harmonikave që lindin gjatë proceseve kalimtare është e nevojshme që të perdoret Oshiloskopi.

**Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

**Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.**

## **I. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Nisur nga historiku i defekteve të ndodhura tek RELE-të e vjetra , KESH sh.a. kërkon të kryejë rinovimin e sistemit të mbrojtjes për 2 (dy) agregatë me furnizim-vendosje / konfigurim / komisionim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese për agregatët Nr.2 dhe Nr.4. Specifikimet teknike janë hartuar konform standarteve europiane ose ekuivalente, për të instaluar të gjithë funksionet mbrojtëse, të cilat suportohen nga teknologjitë e fundit të releve dixhitale. Parametrat e releve dixhitale janë kërkuar në mënyrë të tillë që të sigurohet saktësi dhe shpejtësi në procesimin e të dhënave, për të garantuar veprim të saktë, selektiv dhe të sigurtë të mbrojtjes rele.

Referuar standarteve dhe rekomandimeve europiane janë kërkuar funksione shtesë të mbrojtjes së gjeneratorit dhe transformatorit, të cilat do të integrohen në SCADA-n ekzistuese.

Duke marrë shkas nga historiku i veprimit të mbrojtjeve në HEC Fierzë, ku kemi patur të bëjmë me veprim të gabuar të mbrojtjes diferenciale (për defekte jashtë zone), në specifikime teknike ka disa kërkesa të veçanta në lidhje me funksionet e mbrojtjeve diferenciale, për të garantuar saktësi dhe selektivitet.

## **Njësia e Prokurimit**